




**UDHËZIME HAP-PAS-HAPI PËR
PAJISJEN ME LEJE MJEDISORE KOMUNALE
PËR NDËRTESAT E BANIMIT KOLEKTIV**

Qershor 2022



UDHËZIME HAP PAS HAPI PËR PAJISJEN ME LEJE MJEDISORE KOMUNALE PËR NDËRTHESAT E BANIMIT KOLEKTIV

Botues: EC Ma Ndryshe Rr. Fehmi
Lladrovci 94, Prizren & Rruga:
Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org 029 222
771 & 038 224 967

Autor: Qendra kosovare për
hulumtime urbane-PRO-
Planning

Ky dokument është realizuar nga
EC Ma Ndryshe, i mbështetur nga
Agjencia Suedeze për Zhvillim
dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
(Sida) përmes Programit të saj
"Human Rightivism" zbatuar nga
Fondi për Zhvillimin e
Komunitetit - CDF. Përmbajtja
dhe pikëpamjet e paraqitura këtu
nuk përfaqësojnë qëndrimin
zyrtar të donatorëve.



Qershor 2022

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	5
1. HYRJA	6
2. QËLLIMI I PUBLIKIMIT	8
3. PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E LMK-VE PËR NDËRTESTAT E BANIMIT KOLEKTIV	9
Hapi 1: Aplikimi për leje mjedisore për ndërtesat kolektive të banimit	9
Hapi 2: Shqyrtimi i dokumentacionit dhe raportit të LMK-së dhe pajisja me leje mjedisore	12
Hapi 3: Regjistri i komunës për LMK - të	13
Hapi 4: Mbikëqyrja inspektuese e zbatimit të masave zbutëse të LMK-së	14
Hapi 5: Masat ndëshkuese	16
4. PËRMBLEDHJE	17

Ky publikim është i strukturuar në 4 seksione:

1. Seksioni i parë, jep një vështrim të përgjithshëm lidhur me zbatimin e legjislacionit mjedisor në Kosovë dhe çështjet kryesore me të cilat përballen komunitetet gjatë menaxhimit të problemeve mjedisore në praktikë.
2. Seksioni i dytë, tregon qëllimin e hartimit të publikimit
3. Seksioni i tretë, analizon kornizën ligjore përkatëse dhe përshkruan hapat e nevojshëm deri te marrja e LMK-së për ndërthesat e banimit kolektiv.
4. Seksioni i katërt përmbledh rekomandimet për përmirësimin e rrjedhës së punës gjatë procedurave të lëshimit të LMK-së.

SHKURTESAT

Shkurtesat	Kuptimi
AMMK	Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
AKPMH	Autoriteti Komunal Përgjegjës për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor
BE	Bashkimi Evropian
LMK	Leja Mjedisore Komunale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
UA	Udhëzim Administrativ
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

1. HYRJA

Kosova vazhdon angazhimin e saj në harmonizimin e legjislacionit nacional me direktivat e BE-së, por ende mbetet sfidë implementimi i tyre. Këtë e paraqet edhe "Raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë"¹, i cili vë në pah se edhe pse janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane të veprimit për të gjithë sektorët mjedisorë, si në nivelin qendror dhe atë lokal, niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm. Përkundër faktit se gjatë vitit 2020 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjedisin janë ende në numër shqetësues. Sipas këtij raporti, në mesin e ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore me theks të veçantë në nivel lokal, veçohen kapacitetet e limituara të komunave në sektorin e mjedisit, numri i vogël i zyrtarëve dhe inspektorëve të mjedisit.

Përmes legjislacionit përkatës, përgjegjësitë në mbrojtjen e mjedisit janë ndarë në të dy nivelet e qeverisjes. Komunat brenda territorit të tyre janë përgjegjëse për përgatitjen e planit lokal të veprimit në mjedis dhe zhvillim të qëndrueshëm në bashkëpunim me MMPHI-në, zbatojnë ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të tyre, përgatisin dhe sigurojnë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm. Ndonëse është rritur buxheti për projekte kapitale mjedisore si dhe numri i projekteve nga donatorët, nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë. Krahas problemeve që kërkojnë zgjidhje përmes investimeve kapitale, ka të tilla zgjidhja e të cilave varet vetëm nga zbatimi i legjislacionit mjedisor nga komunat.

Hulumtimet e fundit të bëra nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale, kanë vënë në pah se problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët në komunat e Kosovës kanë të

¹ MMPHI/AMMK, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit 2020

bëjnë me mjedisin. Sipas GAP², kategoria e mjedisit përbën mbi 50% të problemeve të identifikuar nga qytetarët nëpër komuna. Edhe sipas MAPL³, komunat përballen me vështirësi të shumta në fushën e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ndotjen e ajrit dhe deponitë e parregullta.

Lejet mjedisore komunale (LMK) janë një nga instrumentet kryesore që komunat përdorin për menaxhimin e mjedisit në territorin e tyre. Procesi i ndërtimit në Republikën e Kosovës nënkupton zhvillimin e procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 04/L – 110 për ndërtim, në tre hapa themelorë si:

- Marrja e kushteve ndërtimore;
- Marrja e lejes së ndërtimit;
- Marrja e certifikatës së përdorimit.

Për kategoritë e caktuara të objekteve, të gjitha lejet dhe pëlqimet tjera shoqëruese të nevojshme siç është edhe LMK-ja, merren gjatë procedurave të ndonjërit nga këta tre hapa kryesorë. LMK-të jepen për një kategori të caktuar të ndërtesave, siç i ka përcaktuar shtojca 7 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017. Duke marrë parasysh presionin e madh për ndërtim të ndërtesave të banimit kolektiv, sidomos në komunat e mëdha, informatat e siguruar nga zyrtarët mjedisorë nga disa komuna tregojnë që afërsisht 80% të LMK-ve të lëshuara gjatë vitit i takojnë kësaj kategorie.

Një dukuri e shpeshtë e cila është vërejtur në praktikë është se gjatë ndërtimit të objekteve të banimit kolektiv, ka raste kur zhvillimi në terren e tejkalon kapacitetin e lejuar me kushtet e ndërtimit, bazuar në të cilat është lëshuar edhe LMK përkatëse, e cila me këtë rast nuk rishikohet. Pra, ndryshimi i kushteve ndërtimore gjatë zbatimit të projektit - shtimi i etazheve në ndërtesa të banimit kolektiv, me ose

² GAP, 2019: Probleme pa zgjidhje?

³ MAPL, 2021; RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Janar - Dhjetor 2020

pa lejen e AKPMH-së, nuk shoqërohet edhe me rishikim të raportit për LMK në mënyrë që në të reflektohet gjendja e ndryshuar. Pengesë për këtë është edhe korniza ligjore ekzistuese me të cilën nuk parashihet detyrimi për rishikim të LMK-së për rastet e lartpërmendura. Në anën tjetër, ani pse ligji parashih zhvillimin e inspektimit të objekteve për të verifikuar zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në LMK, kjo në praktikë nuk arrihet të zbatohet plotësisht.

2. QËLLIMI I PUBLIKIMIT

Ky publikim është një vazhdimësi e përpjekjeve të përbashkëta të dy organizatave, EC Ma Ndryshe dhe Qendra Kosovare për hulumtime urbane – PRO - Planning, për të ngritur kapacitetet e zyrtarëve komunalë për trajtimin e problemeve mjedisore në komunë.

Publikimi ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të qartë të veprimeve që duhet të ndërmerren gjatë udhëheqjes së procedurës për pajisje me LMK për ndërtesat e banimit kolektiv, në përputhje me kërkesat ligjore. Kjo pritet të ndikojë në përmirësimin e rrjedhës së punës në komuna sa i përket lëshimit të LMK-së për ndërtesat e banimit kolektiv dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre.

3. PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E LMK-VE PËR NDËRATESAT E BANIMIT KOLEKTIV

Sipas shtojcës nga UA -01/2017, për marrjen e lejes ndërtimore për ndërtesat e banimit kolektiv me sipërfaqe në bazë mbi 450 m² ose në sipërfaqe totale mbi 1,500 m², paraprakisht duhet të sigurohet edhe leja mjedisore komunale (LMK). Aplikimi për LMK bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore dhe përveç tjerash përmban raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve apo projekteve në mjedis, të hartuar në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Aplikimi për LMK bëhet sipas procedurave të përcaktuara me UA Nr. 01/2017 për lejet mjedisore komunale. Në vijim janë dhënë hapat e nevojshëm deri te marrja e LMK-së për ndërtesat e banimit kolektiv.

Hapi 1: Aplikimi për leje mjedisore për ndërtesat kolektive të banimit

- 1.1. Aplikuesi parashtroi kërkesën për LMK për ndërtesën e banimit kolektiv, në drejtorinë përkatëse të komunës. Formularit të aplikimit i cili mund të merret në sportelin e komunës duhet ti bashkëngjiten:
 - Kërkesa për pajisje me LMK-në e cila duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, statusin juridik të aplikuesit dhe emrin e projektit;
 - Certifikata për regjistrimin e biznesit (në origjinal);
 - Certifikata e pronësisë (në origjinal);
 - Kopja e planit (në origjinal);
 - Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës në rastet kur ngastra nuk është pronë e aplikuesit;
 - Raporti për LMK-në në tri kopje në formë të fizike (të shtypur) dhe një kopje në formë elektronike, i nënshkruar nga aplikuesi dhe hartuesi.

- 1.2. Zyrtari komunal në sportel kontrollon plotësinë e kërkesës dhe në rast të dokumentacionit jo të plotë informon aplikuesin për plotësimin e mundshëm të saj;

Shënim:

Në praktikë, ani pse nuk është kërkesë ligjore, në një mori rastesh zyrtari komunal mjedisor kërkon nga aplikuesi të pajiset me kushtet ndërtimore për ndërtesën e banimit kolektiv. Kjo bëhet me qëllim që të kuptohet shtrirja e objektit në parcelë dhe rregullimi i hapësirës përreth.

Në rastin kur aplikuesi në procedurë përfaqësohet nga personi i autorizuar, kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe autorizimi i noterizuar.

Rekomandim:

Megenëse gjatë aplikimit për leje ndërtimore dhe për LMK kërkohet dorëzimi i dokumentacionit të njëjtë origjinal, rekomandohet që në rastin e aplikimit për LMK, të mund të shfrytëzohen kopjet, duke pasur parasysh që origjinalet veçse janë dorëzuar në drejtori gjatë aplikimit për leje ndërtimore. Kjo do të evitonte koston e panevojshme për palën dhe do të racionalizonte kohën e përpunimit të lëndës.

Komunat mund të përgatisin një listë kontrolli e cila paraprakisht i jepet aplikuesit për t'i mundësuar informacion më të detajuar rreth përmbajtjes së raportit të LMK-së, ashtu që të sigurohet se raporti i tyre t'i përmbajë të gjitha të dhënat e kërkuara.

1.3. Raporti i LMK – së, i cili duhet të jetë jo më shumë se 10 faqe, ka këtë përmbajtje:

- Përshkrimi i projektit;
- Përshkrimi i pajisjeve dhe procesit teknologjik;
- Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis;
- Përshkrimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis;
- Vlera investuese të projektit;
- Masat për rehabilitimin e sipërfaqes pas përfundimit të aktivitetit.

Rekomandim:

Komunat mund të përgatisin një listë kontrolli me parametrat më të rëndësishëm që një LMK për ndërtesat e banimit kolektiv duhet t'i përmbajë, e cila paraprakisht i jepet aplikuesit për t'i mundësuar informacion më të detajuar rreth përmbajtjes së raportit të LMK-së, ashtu që të sigurohet se raporti i tyre t'i përmbajë të gjitha të dhënat e kërkuara.

1.4. Raporti hartohet nga personi fizik ose juridik, të cilët mbajnë përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave të paraqitura. Raporti nënshkruhet nga hartuesi dhe raportuesi.

Shënim:

UA për LMK i referohet hartimit të raportit nga personi fizik ose juridik, por nuk specifikon nëse ata duhet të kenë licencë përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Kjo bën që në shumicën e rasteve raportet e LMK-ve të hartohen edhe nga persona me përgatitje joadekuate profesionale, dhe rrallëherë ndodh që raporti të hartohet nga personat apo kompanitë që veçse mbajnë licencë për hartimin e raporteve të VNM-së.

Hapi 2: Shqyrtimi i dokumentacionit dhe raportit të LMK-së dhe pajisja me leje mjedisore

- a. Shqyrtimi dhe vlerësimi i raportit të LMK-së bëhet nga një Komision Profesional i përbërë nga tre anëtarë, i cili themelohet me vendim të drejtorit të Drejtorisë përkatëse komunale (sipas nenit 10 të UA për LMK). Komisioni profesional është autoritet, përgjegjësia e të cilit është të jep vlerësimin për miratimin apo refuzimin e dhënies së LMK-së.

Shënim/rekomandim:

UA për LMK, nuk ka përcaktuar se kush duhet të kryesojë Komisionin, por në praktikë zakonisht kjo përgjegjësi bie mbi zyrtarin mjedisor komunal. Ka komuna, të cilat përcaktimin e anëtarëve të Komisionit e bëjnë ashtu që dy prej tyre janë anëtarë të përhershëm, kurse i treti përcaktohet varësisht nga natyra e kërkesës që paraqitet për shqyrtim.

Në praktikë ndodh që pjesë e Komisionit është Inspektori mjedisor, por meqenëse ai do të mbikëqyr zbatimin e masave të propozuara me raport të LMK-së gjatë ndërtimit të objektit, nuk rekomandohet që ky zyrtar të jetë anëtar i Komisionit.

Ani pse nuk kërkohet me UA, në praktikë, anëtarët e Komisionit dalin në terren për të vëzhguar lokacionin se ku do të ndërtohet objekti. Për takimet e Komisionit për shqyrtimin e lëndës mbahet procesverbal.

- b. Përshkrimi i procedurës:
 - Pas shqyrtimit të raportit nga Komisioni, në rast të miratimit të kërkesës, bëhet llogaritja e tarifës për LMK, e cila sipas UA Nr. 01/2017 përcaktohet në vlerë prej 0.2% të vlerës investuese të projektit;
 - Përgatitet akti administrativ – vendimi për miratim ose refuzim të LMK-së i cili nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë përkatëse;
 - Vendimi i dorëzohet aplikuesit në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e pranimi të kërkesës. Në rast refuzimi, aplikuesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë në MMPHI brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga marrja e vendimit për refuzim.
- c. Pas njoftimit për marrjen e vendimit për miratim të kërkesës për LMK, aplikuesi kryen pagesën e tarifës së llogaritur nga Komisioni në mënyrë që të pajiset me LMK. Për këtë proces mbahet procesverbal i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit dhe aplikuesi, me ç' rast ai zotohet se merr përsipër zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara me LMK gjatë fazës së punëve përgatitore (përgatitjes së terrenit dhe punëve të gërmimit) dhe gjatë fazës së ndërtimit.

Hapi 3: Regjistri i komunës për LMK - të

- 3.1. Për LMK-të e lëshuara, mbahet regjistër sipër mënyrës së përcaktuar me UA Nr. 01/2017.

Rekomandim:

UA Nr. 01/2017 nuk ka dhënë përcaktim nëse regjistri i lejeve të LMK-ve duhet të jetë i publikuar në ueb-faqen e komunës. Duke qenë se për LMK-të nuk organizohet debat publik, rekomandohet ofrimi i qasjes në regjistrin e LMK-ve për të mundësuar kështu transparencë ndaj banorëve që jetojnë në afërsi dhe publikut të gjerë.

Hapi 4: Mbikëqyrja inspektuese e zbatimit të masave zbutëse të LMK-së

4.1. Mbikëqyrja inspektuese e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe akteve të tij si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të propozuara me LMK bëhet nga inspektori komunal për mjedis. Në mungesë të këtij kuadri, sipas ligjit, punët e inspektorit mund t'i kryhen edhe ndonjë zyrtar tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon komuna. Me UA Nr.01/2017, janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e Inspektorit.

Autorizimet e inspektorit:

- Të urdhërojë operatorin ta fillojë procedurën e LMK-së brenda afatit prej tridhjetë ditësh;
- Të ndalojë ekzekutimin e punëve dhe operimit derisa operatori nuk pajiset me LMK nga komuna;
- Të urdhërojë përmbushjen e plotë të kushteve dhe zbatimin e masave të përcaktuara me
- vendimin për LMK-në e lëshuar nga Komuna;
- Të ndalojë kryerjen e aktivitetit të operuesit deri në përmbushjen e plotë të kushteve të përcaktuara në vendimin për LMK-në.

UDHËZIM HAP-PAS-HAPI PËR PAJISJEN ME LEJE MJEDISORE KOMUNALE PËR NDËRTHESAT E BANIMIT KOLEKTIV

HAPI 1

KËRKESA

CERTIFIKATA
E BIZNESIT

CERTIFIKATA
E PRONËSISË

KOPIJA E
PLANIT


KONTRATA E
SHFRYTËZIMIT
TË NGASTRËS

RAPORTI I LMK-së (3 kopje të shtypura, 1 elektronike)

- Përshkrimi i projektit
- Përshkrimi i pajisjeve dhe procesit teknologjik
- Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis
- Përshkrimi i masave për zvoglimin e ndikimeve negative në mjedis
- Vlera investuese e projektit
- Masat e rehabilitimit të sipërfaqes pas përfundimit të aktivitetit

DËSHMIA E
PAGESËS SE
TARIFËS

HAPI 2



HAPI 3

HAPI 4

Grafiku 1 Procedura e lëshimit të Lejes Mjedisore Komunale për ndërtesat e banimit kolektiv

Hapi 5: Masat ndëshkuese

5.1. Për personin juridik ose fizik i cili nuk i zbaton dispozitat ligjore të përcaktuara me UA Nr. 01/2017 për LMK si dhe masat e propozuara me vendimin e LMK-së, aplikohen dispozitat për gjobitje sipas Ligjit për Kundërvajtje, Nr.5/L-087.

Shembull: Dispozitat ndëshkuese

- Me gjobë në të holla prej dymijë e pesëqind (2,500) deri në pesëmijë euro (5,000), gjobitet për kundërvajtje personi juridik ose fizik, nëse jep të dhëna jo të sakta në raportin e LMK-së dhe nuk i përmbush kushtet sipas vendimit të kësaj leje;
- Me gjobë në të holla prej dyqind e pesëdhjetë (250) deri në pesëqind euro (500), dënohen të gjitha subjektet afariste ekzistuese, të cilët nuk janë të pajisura me LMK dhe nuk e kanë paguar taksën;
- Me gjobë në të holla prej pesëqind (500) deri pesëmijë euro (5,000) do të dënohen të gjitha subjektet të cilat e kanë LMK-në dhe nuk i përmbahen raportit të saj dhe vetë LMK-së;

Burimi: Shembulli i Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale i komunës së Rahovecit

4. PËRMBLEDHJE

Ky publikim ofron udhëzime hap-pas-hapi mbi aplikimin e procedurave standarde për pajisjen me LMK për ndërtesat e banimit kolektiv, në mënyrë që të ndikohet në përmirësimin e rrjedhës së punës për zyrtarët mjedisorë në komuna dhe rrjedhimisht eliminimin e burokracisë së mundshme gjatë procesit të dhënies së lejes ndërtimore për këto ndërtesa por edhe kostove të panevojshme të krijuara gjatë kryerjes së procedurave të tilla.

Intervistat dhe analizat e bëra gjatë zhvillimit të këtij publikimi, kanë vënë në pah mangësi të cilat është e domosdoshme që të adresohen dhe trajtohen nga institucionet përgjegjëse. Rekomandimet të cilat janë ofruar në secilin hap të procedurës së LMK-së, janë përmbledhur si në vijim:

- Zhvillimi i një procedure të bashkërenduar, të standardizuar dhe të qartësuar në hapa ndërmjet marrjes së lejes ndërtimore për ndërtesat e banimit kolektiv, pëlqimeve të nevojshme (p.sh. për kyçje në infrastrukturën e ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit energjik, telekomunikacionit, ngrohjes qendrore etj), analizave gjeoteknike, lejes mjedisore, lejes ujore etj. Kjo mund të arrihet përmes një udhëzuesi të hartuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës apo ndonjë Rregulloreje të standardizuar komunale e zhvilluar përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës.
- Ndryshimi/plotësimi i UA Nr. 01/2017 për lejet mjedisore komunale, për të adresuar çështjet si:
 - o nevojën e plotësimit të kërkesë nga aplikuesi me dokumentacion tjetër të nevojshëm si p.sh. me kushtet e lokacionit për ndërtesën;
 - o përfshirja e ndonjë dispozite për publikim të regjistrit dhe raporteve të LMK-ve në ueb faqen e komunës për të bërë publike dhe siguruar proces transparent gjatë

- zbatimit të masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit apo minimizimin e tyre, të propozuara me LMK;
- qartësim se kush mund të jetë personi fizik apo juridik që harton raportet e LMK-së, në mënyrë që të sigurohet se raportet hartohen nga persona me përgatitjen e duhur profesionale dhe mbajnë përgjegjësi përmes ushtrimit të kësaj veprimtarie;
- qartësim edhe i roleve dhe përgjegjësive të akterëve tjerë si zyrtarit mjedisor, përbërjes së Komisionit vlerësues të LMK-ve, inspektorit mjedisor etj.;
- përfshirja e ndonjë dispozite e cila trajton çështjen e plotësimit të LMK-ve në rast se ndryshojnë kushtet ndërtimore për ndërtesën e banimit kolektiv, si dhe detyrimi për rishikim të LMK-së në rastet e tilla;
- Forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendim i veprimtarive ndërmjet dy pushteteve (qendror dhe lokal) me qëllim zbatimin më të mirë të kornizës ligjore, por edhe mbështetje në ngritjen e sistemit të informacionit mjedisor në nivel lokal për informimin të publikut përmes komunikimit elektronik.

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijës empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.


Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi

duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.



<https://ecmandryshe.org/>